

VENDIM
Nr. 599, datë 18.10.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI
I PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION
I RRUGËS INDUSTRIALE (TREGU), POGRADEC”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, dhe me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugës industriale (tregu), Pogradec”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Pogradec.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë sipërfaqe “trual” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme të shpronësimit prej 7 665 468.5 (shtatë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 7 665 468.5 (shtatë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë pesë) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Pogradec.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Pogradec, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec dhe Bashkia Pogradec për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

LISTA PARAPRAKE E SHPRONËSIMEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I PROJEKTTIT “RIKONSTRUKSION I RRUGËS INDUSTRIALE (TREGU)”

		Pronari		Zona	Numri i		-	-			-	Tokë truall		Vlera		
Nr .	Emri	Atësi a	Mbiemri	kada s.	pasuris ë	Sip. total e	Sip shpron. m²	Lloji i pasuri së	Çmimi (lekë/ m²)	Vlera (lekë)	Sip (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	totale lekë	Konfirmi me	Shënime
1	Adriati k	Vait	Jakupllari	8581	5/265	23	23	Ndërte së	32381	744763						Bllokuar në favor të z. G. Kancellari
2	Adriati k	Vait	Jakupllari	8581	5/266	21.5	21.5	Ndërte së	32381	696191 .5						
3	Adriati k	Vait	Jakupllari	8581	5/267	21.5	21.5	Ndërte së	32381	696191 .5						
4	Adriati k	Vait	Jakupllari	8581	5/268	21.5	21.5	Ndërte së	32381	696191 .5						
5	Adriati k	Vait	Jakupllari	8581	5/269	23	23	Ndërte së	32381	744763						Bllokuar në favor të z. L. Kllomollari
6	Valbo na	Vasil	Kacori (Kerthi)	8581	5/375- N1	23.5	23.5	Ndërte së	32381	760953 .5	10	10491	104910	865863. 5		
7	Elda	Vasil	Spirollari	8581	5/375- N2	23.5	23.5	Ndërte së	32381	760953 .5	10	10491	104910	865863. 5		
8	Gjergji	Vasil	Kerthi	8581	5/375- N3	64	64	Ndërte së	32381	207238 4	27	10491	283257	2355641		
										359429 1				TOTAL =	7665468.5	